*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

E martë, 6 qershor 2023

[Seancë e hapur]

[I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur.

Znj. Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mirëdita. Kjo është lënda KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. Prokuror, ju lutem na prezantoni me pjesëmarrësit e ekipit sot.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita. Sot është Line Pedersen, Giulia Bianchi, Gaia Pergolo dhe De Minicis për ZPS-në.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtës i Viktimave.

Z. LAWS: [Përkthim] Mirëdita. Jam Simon Laws, Mbrojtës i Viktimave në këtë çështje gjyqësore së bashku me bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëdita, e nderuar Gjykatëse. Jam Jean-Louis Gilissen. Jemi këtu së bashku të z. Shala. Është i njëjti ekip siç ishte dje znj. Cariolou, z. Aouini. Nuk besoj se duhet që t'i marrë të gjithë me radhë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbajtëm shënim që ju thatë se keni të njëjtën përbërje të ekipit.

Z. AOUINI: [Përkthim] Pikërisht kështu. Me përjashtim të përkthyeses që nuk është këtu.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po edhe kjo është e rëndësishme.

Z. AOUINI: [Përkthim] Sigurisht.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Shala, na dëgjoni në rregull?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj. Mirëmëngjes.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëmëngjes. Shumë mirë. Do të vazhdojmë sot me dhënien e dëshmisë së Dëshmitarit 1. Edhe sot do të kemi të njëjtën mënyrë të zhvillimit të seancave si dje me seancat e zakonshme një orë e gjysëm.

Z. Avokat i Mbrojtjes, ju na thoni dhe se dhe sa kohë ju duhet sot paradite përafërsisht?

Z. AOUINI: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

Mirdita, të pranishmeve në sallë.

Po, dëshirojmë që t'ju japim përditësim. Sigurisht kemi bërë një vlerësim të atyre që kemi kaluar dhe çfarë na kanë mbetur, vlerësojmë se do të na duhen dhe maksimumi 15 minuta, në mos më pak, varet sesi do të jenë përgjigjet. Do të mbyllim një dokument diskutimi që kishim dje. Do të japim numrin e referencës për transkriptin. Dhe pastaj do të kalojmë në temën e fundit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.

Pastaj mund të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit nëse s'ka asnjë problem për të ngritur? Në rregull. Faleminderit.

Znj. Asistente e Sallës, ju lutem shoqëroheni dëshmitarin të hyjë në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëdita, z. Dëshmitar.

DËSHMITARI: Mirëdita.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si jeni sot?

DËSHMITARI: Mirë. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Shala, konfirmoni se e dëgjoni dëshmitarin?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e ndëgjoj mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Z. Dëshmitar, ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të vërtetën. E kuptoni?

DËSHMITARI: Po.

DËSHMITARI: TW4-01 [Vijon]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

Atëherë do t'ia jap fjalën Avokatit të Mbrojtjes. I cili do të vijojë me pjesën e fundit të kundrapyetjeve të tij dhe pastaj do të shohim nëse do të ketë apo jo nevojë për një raund të dytë, për një herë të dytë, të palës tjetër të Mbrojtësit të Viktimave. Dhe pastaj në fund do të jenë pyetjet nga Trupi Gjykues.

z. Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

Pyetjes të palës tjetër nga Z. Aouini: [Vazhdim]

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Mirëdita, z. Dëshmitar.

PË. Mirdita.

Z. AOUINI: [Përkthim] E nderuara Gjykatëse, duhet të kalojmë në seancë private për ta përfunduar pikën e fundit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, duhet të kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse PY. Dje folëm, diskutuam për një temë të cilën duhet ta mbyllim. Nuk do të zgjasë shumë. Dhe pastaj do kalojmë në temën e fundit, t'ju bëj pyetjet e fundit që kam.

Na thatë ditën e premte, z. Dëshmitar, në faqen e transkriptit 1617, se nuk keni pasur kurrë dokumente të lëshuara nga autoritetet serbe. Dhe këtu po lexoj, pyetja ju bë:

"A e morët pasaportën tuaj me vete?"

Ju thatë:

" Jo, jo, unë kurrë në jetë time s'kam pasë dokumente të serbit *[REDAKTUAR]*".

Edhe dje, në faqen 1852, na thatë se:

"Nuk e keni kalu asnjëherë kufirin për të kaluar në territorin serb pas përfundimit të luftës. Dhe nëse e lexoj nga rreshti 17 thatë që s'kam kalu kurrë në territorin serb pas fundit të luftës, sepse e di se me të shkel këmba aty, kam frikë se do më ndalojnë e do më detyrojnë të jap ndonjë deklaratë, e për këtë arsye nuk kam udhëtu në atë mënyrë edhe nuk do shkoj edhe në 50 vitet e ardhshme".

Pra, ky është konteksti për të cilën do ta bëj pyetjen në

vijim.

Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e di nëse mund të nxjerrin në ekran një dokument, të cilin mund t'ia lexojmë dëshmitarit dhe t'i kërkojmë përgjigje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]. Po nuk është e mundshme ta bëni pyetjen paraprakisht? U dashka që ta lexoj dokumentin që të japë përgjigje?

Z. AOUINI: [Përkthim] Ka diçka --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbase e kuptoj se ku e keni qëllimin. Mund të keni nevojë për një sqarim lidhur me dokumentin.

Z. AOUINI: [Përkthim] Është vetëm një fjali. Është mënyra më efikase.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Znj. Sekretare e Gjykatës, ju lutem pasi të merrni numrin e dokumentit nga Avokati, ta nxirrni në ekran.

Z. AOUINI: [Përkthim] Pa. Është me numër ERN 058583 deri 058585 RED2, *[REDAKTUAR]*, faqja 2, paragrafi 7.
Dhe është i njëjti numër ERN dhe e njëjta faqe, i njëjti paragraf për versionin në shqip. Numri ERN ka në fund fare - AT.

PY. Në paragrafin 7 thotë:

*[REDAKTUAR]* Një

herë e pashë në *[REDAKTUAR]*kur kisha një pasaportë të vjetër serbe”.

Z. Dëshmitar, këtu ka tre informacione për të cilat dua të jap mundësinë që të komentoni. Së pari, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* që është një qytet në Serbi që këtu keni thënë se keni qenë rreth *[REDAKTUAR]*. Pra, pas lufte. Dhe këtu keni thënë që kishit një pasaportë të vjetër serbe, pra, një dokument të lëshum prej Serbisë. Ju lutem mund të përgjigjeni në këtë.

PË. Këtu po shkrun pasaportë të vjetër, unë kurrë në jetë s’kam pasë para lufte pasaportë të Serbisë, as letërnjoftim, dokument. Asnjë dokument të Serbisë nuk e kam pasë para lufte. Këtu po shkrun fort mirë të vjetër, e të vjetër unë s’kam pasë kurrë. As të vjetër as të re në kohë të Serbisë.

PY. Sa i takon *[REDAKTUAR]*, qytetit të *[REDAKTUAR]* a mund të përgjigjeni?

PË. Çka mund t’u përgjigj për *[REDAKTUAR]* tregomë? Unë ta kthej përgjigjen.

PY. Z. Dëshmitar, këtu thuhet që keni qenë në *[REDAKTUAR]* që është në territorin serb. A e keni kaluar ndonjëherë kufirin për të hyrë në territorin serb apo jo ndonjëherë?

PË. Në *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Puna mos po më arrestojnë për me dhanë ndonjë dëshmi. Sepse kur të kapin serbët çdo kush e dinë se nuk të mëshojnë pa i

marrë shënimet, hetimet e veta. Dhe që tash me shku nuk më lëshojnë. Prej atëherit s'kam shkel më, as nuk hij. Dhe jam kanë me njëri të sigurtë shumë se më ka garantu. Dhe kurrë më nuk kam qenë.

PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Do të kalojmë tani në temën e fundit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, dëshiroj unë t'i bëj një pyetje dëshmitarit.

Z. AOUINI: [Përkthim] Po, ju lutem.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, ju është bërë pyetja më parë nëse keni qenë ndonjëherë apo jo në Serbi. Dhe ju fillimisht keni thënë jo. Tani, kur Avokati i Mbrojtjes ua tregoj këtë dokument, thatë se keni qenë njëherë *[REDAKTUAR]*. A mund t'i thoni Trupit Gjykues pse nuk e treguat menjëherë këtë gjë?

DËSHMITARI: Pse e kam harru. E kur e lexova qetash më ra ndërmend. Nuk kam çka me mohu këtë punë. Po e kam pasë harru, se s'mu ka duk diçka interesante, s'më ka ra në mend. Nuk është gja për me mshef kjo punë. Kështu.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Do të bëjmë një pushim prej 20 minutash. Njësia e Administrimit të Gjykatës do të lehtësojë kontaktin ndërmjet të akuzuarit dhe ekipit të Mbrojtjes së tij. Dhe pastaj do kthehemi përsëri në sallë në mënyrë që të mund të vazhdojmë me kundërpyetjen e dëshmitarit. Në rregull?

Seanca ndërpritet për 20 minuta.

--- Pauza fillon në orën 10.02.

--- Seanca rifillon në orën 10.20

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se erdhët.

E shohim që jemi siç ishim përpara pushimit. Shoh konfirmim nga palët. Kjo u mbajt shënim për procesverbal. Z. Shala, është po ashtu i pranishëm.

Do t'ju jap fjalën, Avokat, sapo të kalojmë në seancë private, në mënyrë të tillë që të ndani opinionet tuaja.

Z. AOUINI: [Përkthim] Mbase mund të përgjigjem në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Preferoj që të kalojmë në seancë private. Do ta lëmë për momentin dëshmitarin, pra, për procesverbal dëshmitari nuk është në sallën e gjyqit.

Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F631*

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Avokat i Mbrojtjes, patët mundësi që të diskutonit me klientin tuaj, kështu?

Z. AOUINI: [Përkthim] Po. Ju falënderojmë për këtë. Diskutuam me klientin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Keni fjalën në mënyrë që të jepni pikëpamjet tuaja lidhur me temën.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Ne kundërshtojmë fort, kundërshtimin e Prokurorisë dhe të Mbrojtësit të Viktimave, për tri arsyet që do të jap më poshtë.

Së pari, kolegu im i nderuar, tha që ne po mundohemi që të paraqesim për pranim prova opinione dhe gjithashtu dha mendimin e vet për marrjen në pyetje të këtij dëshmitari. Ndërkohë që situata është tërësisht e ndryshme. Ne nuk i kërkuam dëshmitarit që të jepte opinionin e vet. Nuk e bëmë fare këtë gjë. Pra, e thashë qartë, dua ta përsëris sërish, që ne japim informacion dhe përderisa ai foli për dëshmitarë individualë, ne i lamë atij mundësinë që t'i përgjigjej me informacionet në qoftë se ky informacion ose besim vjen nga hetuesit. Kjo është pika e parë.

Pika e dytë është kjo. Nuk bëhet fjalë për një opinion.

Po bëhet fjalë për një besim. Besimi dhe opinioni janë dy gjëra të ndryshme. Pra, është besimi i një hetuesi profesionist që është marrë me këtë çështje. Pra, nuk e lexoj në dokumentin që thuhet që "Unë mendoj" ose "Kam opinionin që". Po flitet për besimin e hetuesit, domethënë nuk flasim për opinione. Janë dy gjera të ndryshme.

Ndërkohë argumenti i tretë, është që kjo çështje është trajtuar. Unë personalisht nuk mbaj mend që kam bërë ndonjë pyetje në qoftë se *[REDAKTUAR]*. E kemi diskutuar dje me njëri-tjetrin dhe jemi munduar që të sqarojmë në qoftë se duhet ta paraqesim në ekran dëshminë e dëshmitarit apo jo. Domethënë, unë mendoj që kjo ka qenë hera e parë që unë e kam diskutuar këtë çështje. Ndërkohë që sa i takon pyetjes drejtuar dëshmitarit, kjo është hera e parë që unë do t'ia bëj këtë pyetje dëshmitarit.

Kështu që mendoj që formulimi që kemi përdorur është shumë i saktë dhe mendoj që duhet të lejohemi, që të themi që kemi informacion nga materiali i *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* Domethënë, më troç dhe shkoqur se kaq nuk mund ta themi. Pra, nuk kemi ndryshuar asgjë,, nuk kemi keqpërfaqësuar ose keqparaqitur asgjë që jepet në këtë dokument, kështu që besoj që ne duhet të na jepet leja që të vazhdojmë me këtë pyetje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Shikoj Prokurorin i cili thotë që nuk dëshiron që të bëjë parashtrime të tjera.

Avokati i Viktimave, ju?

Z. LAWS: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, shkurtimisht, më lejoni të them sa më poshtë. Është e vërtetë, lidhur me pikën e parë, që ajo çfarë do bëjë ose çfarë kërkon që të bëjë Avokati i Mbrojtjes është që të mos i kërkojë opinionin e vet dëshmitarit. Është e qartë kjo. Megjithatë pyetja që po bëhet është mbështetur në opinionin e dikujt tjetër të personit tjetër. Ne nuk është se e kemi në sallën e gjyqit për t’i dhënë mundësi vlerësimit të peshës që duhet t’i japim një opinioni të tillë. Pra, nuk është një përgjigje për kundërshtimin, po thjesht e thekson më tepër atë çfarë thamë ne.

Sa i takon pikës së dytë. Sugjerimet që a ka dallim ndërmjet besimit të dikujt dhe opinionit të dikujt, ne sugjerojmë, që është absolutisht e pamundur që të ndahet njëra nga tjetra. Se në qoftë se unë, për shembull, besoj diçka kjo nuk do të thotë që unë, domethënë, në qoftë se besoj diçka, kjo do të thotë që kam një opinion X për diçka. Dhe në qoftë se shohim, për shembull, kufizimin në fjalor të këtyre fjalëve besimi në vetvete mbështetet në përvojë. Kështu jepet përkufizimi.

Sa i takon pikës së tretë, ju kërkoj ndjesë në qoftë se është kjo situata, në qoftë se ne përfunduam pastaj në

skenarin që nuk e bëmë pyetjen për dëshmitarin, ju kërkoj ndjesë për këtë dhe në këtë skenar ku e kemi diskutuar vetëm ndërmjet palëve dhe nuk i kemi bërë dëshmitarit pyetje lidhur me këtë, ju kërkoj ndjesë e tërheq pikën e tretë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Keni ndonjë kundërparashtrim, Avokat i Mbrojtjes.

Z. AOUINI: [Përkthim] Ne i qëndrojmë të gjitha konstatimeve që thashë më përpara.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka disa konstatime që duhet të bëjmë lidhur me këtë pikë dhe duhet që t'i përgjigjemi pyetjes në qoftë se të lejojmë apo jo këtë pyetje.

Nuk bëhet fjalë për pronueshmërinë e provave materiale. Por ka të bëjë me faktin në qoftë se ne do të lejojmë që të bëhet kjo pyetje apo jo.

*[REDAKTUAR]* e cila nuk është bërë më përpara, nuk është diskutuar, thjesht është diskutuar ndërmjet palëve sesi të bëhet kjo pyetje për dëshmitarin. Gjë të cilën ne e diskutuam gjatë e gjerë dje dhe për të cilën kemi dhënë udhëzimet tona si Trup Gjykues dje. Atëherë pyetja shtrohet përpara Trupit Gjykues në qoftë se do ta lejojmë këtë pyetje apo jo.

Avokat i Mbrojtjes, ju patët mundësi që t'ia bëni pyetjen dëshmitarit. Morët një përgjigje të qartë me shpjegime të mëtejshme. Për rrjedhojë, unë nuk do të lejoj pyetje të tjera

lidhur me këtë temë, duke marrë parasysh faktin se dokumenti nuk jep ndonjë bazë të mëtejshme faktike mbi të cilën mund të komentojë dëshmitari. Për ne kjo është vendimtare për të marrë vendimin për të lejuar pyetjen ose jo.

Diskutimi lidhur me opinionet dhe besimet. Ndonjëherë mund të jetë me shumë vlerë që t'i parashtrohet dëshmitarit kjo, megjithatë, mendoj që kjo temë është shtjelluar mjaftueshëm.

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Tani do të thërrasim përsëri dëshmitarin në sallën e gjyqit.

Avokat, në qoftë se e kuptoj mirë, ka edhe një tjetër temë që dëshironi të diskutoni me dëshmitarin apo kjo ishte e fundit?

Z. AOUINI: [Përkthim] Jemi në mes të temës së fundit. Pra, kam edhe disa pyetje të tjera për dëshmitarin përpara sesa të përfundojmë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Asistente e Sallës, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

Sa i takon seancë private, dua t'ju them që patëm një

grup shumë të madh personash në galerinë e publikut, kështu që doja që të shmangja rrjedhjen e informacionit sepse në qoftë se do të dëgjohej informacioni mund të kishte rrjedhje informacioni dhe do ishte e pamundur që të bëhen redaktime. Dhe për këtë arsye aplikova këtë rregullin që më mirë të jemi të sigurtë sesa të kemi keqardhje pastaj për ndonjë rrjedhje të mundshme informacioni.

[Dëshmitari vijon dëshminë]
[Seancë private]
[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi tani në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. Dëshmitar, Mbrojtja e ka përfunduar këtu pjesën e kundrapyetjeve të saj, do të pyes Zyrën e Prokurorit të Specializuar për të parë nëse dëshirojnë që t'i bëjnë menjëherë tani pyetjet plotësuese.

Z. Prokuror, do i bëni tani pyetjet plotësuese dëshmitarit?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Nuk kemi shumë. Po përpara se të vazhdojmë do të kërkoja që dëshmitari të shoqërohet të dalë nga salla sepse ka një pikë të cilën do të donim ta diskutonim, për të cilën kërkojmë udhëzime nga Trupi Gjykues nëse do të jetë apo jo e nevojshme për t'i bërë disa pyetje të caktuara dëshmitarit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Z. Dëshmitar, do t'ju shoqërojmë tani të dilni nga salla sepse na duhet që të diskutojmë diçka. Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem, z. Prokuror.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, do të na duhet të kalojmë në seancë private për këtë diskutim.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Faleminderit.

Znj. Sekretare, ju lutem kërkoni që të futet dëshmitari në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, ju falënderoj. Duam që t'ju informojmë se Zyra e Prokurorit të Specializuar do t'jua bëjë pyetjet pas pushimit. Çka do të thotë se tani do të bëjmë ndërprerjen e seancës 30 minuta. Do të rifillojmë në orën 11.20. Dhe atëherë do t'jua bëj pyetjet z. Prokuror.

Faleminderit, që erdhët prapë në sallë, po desha t'ju informojë prandaj dhe ju thirra që të vinit në sallë. Faleminderit.

DËSHMITARI: Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Seanca ndërpritet këtu deri në orën 11.20.

--- Pauza fillon në orën 10.52

--- Seanca rifillon në orën 11.21

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem ulini. Mirë se erdhët.

Do t'i kërkoj asistentes së sallës që të sjellë dëshmitarin në sallën e gjyqit.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

se erdhët, z. Dëshmitar.

Tani do t'i jap fjalën z. prokuror. Dëshironi që të vazhdojmë që të qëndrojmë në seancë të hapur apo të kalojmë në seancë private?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, të nderuar Gjykatës, por pyetjet plotësuese të miat do të duhet që të realizohen të gjitha në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare ju lutem na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë të hapur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. Dëshmitar, të kanë bërë shumë pyetje. Prokurori, Mbrojtja e Viktimave dhe Mbrojtja e të akuzuarit. Tani Trupi Gjykues dëshiron që t'ju bëjë disa pyetjet plotësuese në mënyrë të tillë që të qartësohet më tepër lidhur me disa aspekte që keni mbuluar, keni cekur në dëshminë tuaj përpara gjykatës dhe në dëshmitë e mëparshme.

Do të filloj unë me disa prej pyetjeve të Trupit Gjykues. E kupton?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë. Faleminderit.

Do t'i kërkoj Sekretares së seancës të na kalojë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar. Do të konsultohem me një prej kolegëve dhe pastaj do t'ju drejtohem prapë.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Z. Dëshmitar, do t'ju bëj edhe unë disa pyetje të tjera, por hë për hë do t'ja jap fjalën kolegut tim në të majtën time, i cili do t'ju bëjë disa pyetje. Pastaj pasi të mbarojë ai, do t'ju bëj edhe unë disa pyetjet. Faleminderit.

Keni fjalën.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Kryesuese e Trupit Gjykues, mendoj se duhet të kalojmë sërish në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, na kaloni në seancë publike.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë të hapur.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Dëshmitar, shumë pyetje për ngjarje ju janë bërë. Tani dua që të kem një ide sa i takon situatës në përgjithësi, pra situata e përgjithshme në fabrikën e metalit Kukës. Nuk ka nevojë që të cekni emra, sepse jemi në seancë publike, nëse dëshironi që të cekni emra, duhet të na thoni paraprakisht që të kalojmë në seancë private.

Do të shohim në fillim një vizatim i cili është diskutuar goxha ditën e parë të dëshmisë suaj, të martën e javës që shkoi.

Dua që të paraqesim në ekran dokumentin me numër SITF00012876 deri në SITF00012878, bëhet fjalë për faqen 3. Por çfarë do paraqitet në ekran nuk duhet që të transmetohet publikisht.

Z. Dëshmitar, pikësëpari vizatimin e a shihni, e keni përpara?

PË. Po.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Në rregull, faleminderit. në pjesën e sipërme, aty sipër të vizatimit ka një magazinë të ushqimeve dhe pastaj ka një si katror, shënuar me numrin 3. Është shkruar diçka në anglisht aty, do t'ua lexoj se unë e di që nuk e keni shkruar ju këtë sepse kjo është shkruar në anglisht dhe ju nuk shkruani në anglisht, apo jo? Ju nuk shkruani anglisht?

PË. Jo, nuk shkruaj.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Në rregull. Pra, këtu nëse e kuptoj mirë, se nuk është e lehtë me e kuptu, po aty thuhet "Numër 3: dhoma ku serbët mbajt." Po e përsëris edhe një herë. thuhet dhoma 3, dhoma ku serbët "mbajtur". A e konfirmoni që ju e keni thënë kështu këtë?

PË. Nuk më kujtohet, unë serb nuk kam parë, por e kam pas thanë se e i kam pas ndi tuj bërtit. A kanë provoku ndokush për me na tut a çka, serbisht, ama personat nuk i kam parë. Tash, a kanë -- a ba artist, artista këta tuj bërtit me na shti frikën, kjo që është ndonjë serb, edhe kur e kam pas dhanë deklaratën, q'kështu e kam pas dhanë. Ka qenë pjesë si e dame pak, këtë dhomë e kam pas pasi *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Se vetë me gojë të vet na kanë pas thanë se ju kemi nda, po a është e vërtetë se ka pasur, nuk e di. I kemi ndi tuj fol, me za serbisht, por a kanë lujt hajgare me ne, a s'kanë lujt, nuk e di, ndaj ndokush.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Kur thoni që "i kena dëgjuar ata që flisnin serbisht" kush fliste serbisht?

PË. Nuk e di se nuk i kam parë, veç zanin e ndishim tuj fol serbisht. A kanë lujt këta të shtabit, ndokush hajgare me ne, a kanë e vërtetë, nuk e di, por e kam ndi tuj fol serbisht. Edhe kena mendu se ka të burgosur.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Pra, dëgjuat prej të tjerëve se mund të ketë pasur aty të burgosur serbë, afër magazinës ushqimore. Këtë thatë tashti?

PË. Po.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Ju vetë a i patë a nuk i patë?

PË. Jo, jo, s'i kam parë vetë.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Më thatë edhe se i keni dëgjuar tuj bërtit, pra keni dëgjuar këta të burgosur të tjerë tuj bërtit. Kështu?

PË. Po.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Mund të shpjegoni, të thoni diçka më shumë. Mendoni se ata ishin duke bërtitur se po i trajtonin keq, apo po ziheshin me njëri-tjetrin, pse po bërtisnin këta?

PË. Jo, ne kena dit se janë tuj i trajtu keq, po prapë po të them nuk e di a është e vërtetë, a kanë lujt hajgare me na tut neve, me na frigu, a çka a kanë pyetje. Nuk e di. Ndoshta s'kanë keqtrajtuar asnjë serb aty. Kanë pas me na qit frikën, me na tut. Me sy të mi nuk i kam parë, zanin ua kam ndi, se

dritaret i kemi pasur pa xhama.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Në rregull. Keni parë ndonjë oficer të lartë që të hynte aty në atë dhomë?

PË. S'mundesh me e pa këtë dhomë pa dal jashtë. Pej 1-shit, 2-shit, 3-shit, pa dalë jashtë s'ke mujt. Do a dasht mbrapa dhe me e pa.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit.

Javën që shkoi na treguat se tre romë i mbanin në magazinë, pasta i çuan në dhomën 1. Në transkriptim, në faqen 1440 [sipas përkthimit]. Gjithashtu, na thatë se vendet e tjera përdoreshin për të mbajtur persona të mbyllur. Dhoma 1 dhe dhoma 3. Faqe 1421, rreshtat 19 deri në 20.

A keni dijeni nëse ndërtesa të tjera në fabrikën e metalit të Kukësit përdoreshin për të mbajtur njerëz të mbyllur?

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Mendoj se është mirë të kalojë tani në seancë private.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Në rregull. T'u kthehemi tani këtyre serbëve të cilët i kanë mbajtur mbyllur në atë dhomën që është afër me magazinën. A keni dëgjuar gjë për arsyen pse serbët i kanë mbajtur mbyllur  në një vend ndërsa romët e shqiptarët e Kosovës në një vend tjetër, të mbyllur më vete?

PË. Unë thash se për serbët i kam ndi zanin, me i pa nuk i kam pa. Unë thash kanë mujt edhe me aktru këta për me na shti frikën, me ato të bërtimat e sende por me i pa nuk i kam pa me sytë e mi.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit shumë.

A ishte e mundshme me e pa prej oborrit të fabrikës së metalit të Kukësit që kishte njerëz të mbyllur nëpër godina. Pra, ta zëmë, nëse një njeri hynte aty në oborr, a mundej ai me lehtësi të shihte që kishte njerëz të mbyllur nëpër godina aty brenda?

PË. Prej magazine s'kemi mujt me pa jashtë, veç me dalë te dera, përndryshe s'kemi mujt me e pa, se kanë qenë dritaret nalt shumë. Ma nalt se kjo salla dhe një gjys herë, me siguri. Ma nalt ka qenë dhe s'kemi pas qysh me i pa aty. veç kush ka

hi në magazinë i ka pa, përndryshe s'ka mujt me i pa.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, mund ta hiqni këtë dokument nga ekrani. Faleminderit.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Po, keni ndonjë ide sesa njerëz mund të kenë qenë të burgosur në fabrikën e metalit në Kukës, duke pasur parasysh këto vende të ndryshme brenda kësaj fabrike ku mund të mbaheshin këta njerëz. Sa njerëz mund të kenë qenë mbyllur aty brenda?

PË. Unë kur më kanë çuar në dhomën numër 1, kanë mujt me çune kah në magazinë, ndoshta s’e kanë çu ma kurrkënd. Për dhomën numër 1 dhe 3 di. Unë në dhomën numër 1 më ka ndodh, domethënë, ne 12 vetë kena qenë më së shumti. Ndoshta edhe 13. Kemi qenë nganjëherë 7, varet qysh i kanë lëshue, e qysh e kanë pru dikë, e shifrat varen q’aty. Ama deri në 12 vetë kemi qenë. Nën 5-6, 7, asnjëherë s’kemi qenë në dhomë. Në dhomën numër 1 është fjala se ajo a kanë -- më së shumti ka pas.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Po flas tani për ata që i mbanin të mbyllura, kur e nxirrnin dikë nga dhoma 1, besoj vinin ushtarë që i nxirrnin, apo keni parë ndonjëherë persona të cilët i mbanin aty brenda dhe pastaj i kanë liruar dhe ata janë larguar të pashoqëruar nga fabrika e metalit në Kukës. Keni parë ndonjë herë një gjë të tillë

PË. Jo, pej dhomës gjithmonë ky i ka marrë -- i ka marrë policia ushtarake ose ndonjë ushtar me dikë ka qenë, vetë për

me dalë me ec nëpër oborr, me ja çel derën aty, nuk kam parë.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit.

Sa u takon romëve të cilët i kishin mbyllur bashkë me ju, a dini gjë se mos u kanë kërkuar të bëjnë diçka, apo i kanë detyruar të kryejnë ndonjë detyrë të cilën nuk ua kanë kërkuar të tjerëve me e ba?

PË. Ata i kanë shti me bajt mallra ushqimore, këto, me i mbush kamionët te magazina. Se herë i pas nevojë i kanë marrë ata arabët. Edhe i rrehshin, po edhe i kanë qit me punu, sa herë ka pas nevojë magazina për ushqim, me i mbush kamionët, ose me palu diçka, kur kanë prurë ushqim, të gjithë i kanë marrë ata. Të tre.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] A e dini pse -- arsyen pse këta i detyronin vetëm romët me i ba këto detyrat?

PË. Nuk e di, për besë. Nuk e di, nuk më kujtohet, po s’ka çka me mu kujtu, se ata janë kanë të myllur, ene i kanë detyru. Dashkan a s’dashkan. Edhe te na në Kosovë romët i kanë nënçmuar pak ma tepër. Gjithmonë a kanë --

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Edhe disa pyetje të tjera sa i takon fabrikës së metalit të Kukësit. Natën çfarë keni dëgjuar kur të mbanin në -- kur ju mbanin juve të mbyllur në dhomën numër 1, çfarë dëgjonit natën?

PË. Po kemi dëgjuar biseda, por s’më kujtohen tash fort. E kanë ndodhur kur kanë ardhur ushtarët prej frontit, se ka qenë kush i plagosur, po i kanë pasur plagët, e qysh i kanë

shëndoshur, e din ma mirë. Se i kanë pas familjet e vramë, a vra ndonjë shok i tyre lufte, bërtitshin donin me na hi në dhomë, roja nuk i linte. Kërcënime, [e pakuptueshme] gjithçka në dorë, veç ishte më tepër se kur të na hin, na masakrojnë. Deshën me hi me zor në dhomë, por roja nuk i linte, e mblidheshin ushtarët tuj i ndalë, qe kësoj kërcënime te dritarja, tuj na e shaj nanën, ku a zi e ma zi.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Po të bërtitura njerëzish a keni dëgjuar natën në fabrikën e metalit të Kukësit?

PË. Sa e mbaj mend -- kam harru për besë, por në dhomën teme po, kur na kanë hi në dhomë e në dhoma të tjera, numri 2, kur e binin e kanë sefte, i rrehshin [e pakuptueshme]. Atëherë i kanë pru prapë te dhoma n. 2, i kanë rreh dhe ku i kanë pru te na në dhomë i kanë pru të rrehm. Edhe sefte në qoftë se ka ardh, e kanë prurë të rrehm.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Pra, po më thoni se kur jua sillnin njerëzit në dhomë ishin të rrehur, dhe këtë kuptonit nga shenjat që kishin nëpër trup e nëpër fytyrë, kështu? Këtë doni të thoni?

PË. Po.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Natën, nga dhoma 1 a mund të dëgjonit ju hyrjet e njerëzve, për shembull, në qoftë se vinte ndonjë kerr, a e dëgjohej dot nga dhoma numër 1 natën?

PË. Po se a pa edhe rampa aty, u shijka pej dhomës numër 1, u shijka qoshja e rampës. Kemi mujt me i pa vetura, çka ka hi,

kemi mujt me i pa çlirë. Veç në qoftë se a kanë ulët, s'kemi mujt, përndryshe në qoftë se je kanë në kamë, i ke parë prej dritares. Edhe pej kësaj anës dhe pej kësaj ane. Knejna ke parë oborrin, krejt, komplet, edhe rampën. A pej kësaj tjetrës ke mujt me e pa një tru rampe, pej anës së majtë. A pej anës tjetër, dhomën krej -- oborrin krejt e ke parë. Edhe shtabin. Edhe gjysmën e më tepër të magazinës e ke parë.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] A kishte shumë lëvizje? Hyrje dalje? Kishte shumë vetura që hynin e dilnin?

PË. Po, ka pasur lëvizje, herë ka pasur më shumë, herë më pak, kajhere s'ka pas hiç. Varet qysh i kanë pasur punët.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Na e thatë, na treguat diçka për këtë që do ju pyes tani por dua më shumë informacione nëse mundet. A sillnin rregullisht njerëz ata si të burgosur të rinj në dhomën 1 gjatë natës apo gjatë ditës?

PË. PO varet qysh e kanë kapur njeriun. A ditën, a natën. Qysh e kanë zënë njeriun a qysh e kanë marrë. Krejt a mvar, ditën, natën.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Po, normalisht, të themi ka ndodhur më shumë se një herë apo rregullisht që sillnin të ndaluar, domethënë të burgosur të rinj.

PË. Jo, rregullisht nuk kanë prurë. Se me pas pru rregullisht atëherë u kanë dasht me i pa unë ma së pakti 500-600 veta. S'kanë prurë rregullisht, veç krejt sa janë kanë aty e kanë dashke, krejt i kam pa me sytë të mi, çka kanë shpëtu e çka i

kanë leshu dhe i kanë burgosur, nja katërdhjetë e kusur a -- e më tepër kanë qenë. Dikë e kanë mbajtur dy-tre ditë e kanë lëshuar, dikë dy ditë, dikë një ditë, dikë një javë, dikë dy javë.

Ka njerëz se i kanë pru, nja dy vetë, se s'i kanë prek me dorë hiç, i kanë mbajtur dy-tre ditë dhe i kanë lëshu, nuk i ka rreh kush. Se e ka pas dikë më të madh aty, se e ka pas ndonjë intervenim dhe ka shpëtu.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit shumë. Mendoj se ju përgjigjët edhe një pyetje që kisha dhe po arrij te pyetja e fundit. Sepse në fakt desha që t'ju pyesja se gjithsej, gjithë e gjithë, sa njerëz keni parë që i kanë mbyllur në dhomën 1 gjatë periudhës që ju keni qenë aty [e pakuptueshme] dhe ata të cilët ishin të -- që i mbyllin për një periudhë të kufizuar dhe më duket se ju keni thënë "Nja 40". Ë? Kështu është duket se keni thënë? Po t'i numërojmë të gjithë personat që i kanë futur në dhomën 1?

PË. Afërsisht q'ashtu duhet me kanë, nuk jam tamam i saktë veç kanë prurë boll. Kanë pru, kanë lëshu, kanë majt -- dikë e kanë majt një ditë, dikë dy, dikë tre, dikë një javë.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Pra, kam ardhur kështu te pyetja ime e fundit. Mesa kuptoj ka pasur njerëz të cilët i kanë nxjerrë prej dhomës 1 e të cilët ju nuk i keni parë më kurrë.

PË. Po.

GJYKATËS BITTI: [Përkthim] Faleminderit shumë për durimin. Ju falënderoj. Unë kaq pyetja kisha. Faleminderit, Znj. Kryetare e Trupit Gjykues.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë të hapur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. Dëshmitar, tani do të bëjmë pushimin e drekës për një orë e 30 minuta. Pra pushimi do të zgjas deri në orën 13.45. pas pushimit të drekës, Trupi Gjykues do të vazhdojë me pjesën tjetër të pyetjeve që kemi për ju, do kemi edhe ca pyetje të tjera, megjithatë kjo është pjesa e fundit e dëshmisë tuaj në sallën e gjyqit, dhe besoj që do të përfundojmë sot me dëshminë tuaj.

Faleminderit për momentin, ju bëftë mirë dreka. Do t'i kërkoja asistencës së seancës t'ju nxjerrë nga salla e gjyqit.

DËSHMITARI: Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull, atëherë. Ky është plani për pasditen. Do bëjmë pushim dhe do takohemi sërish në orën 14.15. këtu ndërpritet seanca për momentin.

--- Pauza e drekës fillon në orën 12.42

--- Seanca rifillon në orën 14.15

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se erdhët.

Shoh në të djathtën time që kemi të njëjtën përbërje, nga Prokuroria, nga Mbrojtja e Viktimave edhe nga Mbrojtja e të akuzuarit.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Jemi thuajse të njëjtët. Vetëm Leto Cariolou nuk e kemi me vete.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shikoj z. Shala që na ndjek përmes videolidhjes.

Më dëgjon mirë z. Shala?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes][Mikrofoni çaktivizuar].

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem ndizeni mikrofonin kur të flini, z. Shala, se nuk të dëgjojmë dot.

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] [Mikrofoni çaktivizuar].

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Prapë

nuk ju dëgjomë dot, z. Shala.

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj shumë mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull, tani të dëgjojmë. Pra, z. Shala e dëgjojmë mirë.

Z. Prokuror, e keni ju fjalën.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Një qartësim për procesverbal. Në faqen 49, e nderuar Gjykatëse, juve po e pyesnit dëshmitarin lidhur me një dëshmi të mëparshme që ai ka dhënë për ZPS-në. Ju thatë që është dëshmi që i ka dhënë ZPS-së dëshmitari në 2021, në fakt është dëshmi që ka dhënë në 2019, jo në 2021.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Prokuror, keni të drejtë. E shënuam për procesverbal edhe unë e vura re më pas. Shumë mirë që e sqaruam këtë.

Ndonjë gjë tjetër? Palët duan të ngrenë ndonjë gjë tjetër tani për momentin? Mirë.

Në qoftë se nuk ka gjë tjetër që duhet të ngrihet dua t'i kërkoj Asistentes së Sallës që të sjellë dëshmitarin në sallën e gjyqit.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se erdhët, Dëshmitar.

DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

Shala, e dëgjuat dëshmitarin kur foli?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, po. Ndëgjoj mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Dëshmitar, do t'ju bëj disa pyetje të tjera dhe më pas mund ta përmbyllim marrjen tuaj në pyetje.

Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e njihni njësitin që quhet Njësiti i Zi?

PË. Po ka pasë me njësi të zezë ka pasë shumë. Ka pasë disa njësi. Po këta janë kanë ma të përgatitun. Njësia me tesha të zeza, shka kanë qenë, kanë qenë më të përgatitun edhe ma të vjetër, përvojë më të madhe të luftës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e dini në qoftë se z. Shala ka qenë pjesë ose ka qenë anëtar i këtij njësiti të zi?

PË. Po ka dit, ka qenë se dhe teshat i ka pasë qasi të zeza. Kurrë s'e kam pa me uniformë tjetër, veç me të zeza.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani na thatë që kishte veshë të zeza, uniformë të zezë, por pyetja ime është, në qoftë se të kujtohet, në qoftë se e di, nëse ai ka qenë pjesë e njësitit të zi, në qoftë se e dini, sigurisht, që mund ta thoni këtë.

PË. Nuk e di. Veç e di që njëherë në magazinë se më ka thënë se jam epror. A ka qenë epror nuk e di. Me fjalë të tina po të them edhe unë ty.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit, z. Dëshmitar. Le të kalojmë në një deklaratë të mëparshme të dhënë prej jush. Do t'jua lexoj dhe të shohim në qoftë se kjo deklaratë do t'ju ndihmojë për të rifreskuar kujtesën.

Është dokumenti 059730. Nuk e di në qoftë se e thashë

numrin e saktë. Nuk e di, Sekretare, në qoftë se është numri i saktë ky. Po. Atëherë më thonë që është numri i saktë. Është dokumenti 059730-TR-ET Pjesa 4 e rishikuar. Pra, është përkthimi në anglisht që përkon me përkthimin në shqip, me versionin në shqip në faqen 10, duke filluar në rreshtin 1 të kësaj faqeje.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Cili është numri i faqes në anglisht?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të kërkoj ndjesë, nuk e thashë numrin e faqes. Por, dokumenti është në faqen -- ja ta shikoj, një çast, është faqja 10. Pra, është faqja 9, rreshti i fundit dhe pastaj vazhdon në faqen 10 në fillim fare, rreshti 1.

Në rreshtin 25, ti thua që:

"Ishte anëtar i njësisë speciale me uniformë të zezë. Një njësi speciale, njësia speciale që ishte më e rrezikshmja. Këta ishin më të fortët kanë qenë dhe ka qenë me veprimet më të frikshme, më të rrezikshme".

Tani që ta lexoj, a të kujtohet më shumë informacion lidhur me njësinë speciale që vishte uniforma të zeza?

PË. Trupi Gjykues, unë të thashë këto njësia speciale me tesha të zeza kanë qenë më të pregatitmit, më për luftë në Kosovë. Ke pasë shumë, si mbas tyne që i thojnë Leopardi, Tigrat, njësi speciale ekstra. Ama këta në përgjithësi me tesha të zeza çka kanë qenë, kanë qenë më të pregaditmit për

luftë. Veprimet ma të forta se i kanë ba. Kanë qenë më të stërvitun, ma të ushtrum edhe përvojë më të madhe kanë pasë. Edhe janë zgidhë ekstra, veçantë, ma të gjatë, ma të zhvillum, njerëz ma të guximshëm.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Do ta lë këtu këtë pyetje për momentin.

Z. Dëshmitar, unë ju pyeta më përpara për z. Shala, thashë, ju pyeta se nga kush i merrte urdhrat z. Shala. Kësaj pyetjeje ju u përgjigjët si më poshtë. Domethënë, unë pyes.

"A mund të japësh përgjigje për pyetjen, në qoftë se e dini, çfarë marrëdhënie kishte z. Shala me Xhemshit Krasniqin? Çfarë hierarkie, ça marrëdhënie hierarkie kishin me njeri-tjetrin?

PË. Sot e atë ditë nuk e di. As atëhere. As tashti. Veç e di, se në zyre kanë qenë muhabetet tuj kjeshë, kanë nejt. Këta i dinë më mirë çfarë muhabete kanë pasë. Për me Sabitin e di se i ka marrëdhëniet e mira. Për me Xhemshitin s'e di. Po ata me një shtab q'aty kanë qenë bashkë. Me siguri se i kanë pasë të mira qysh se kanë vepru tani përnjiheri të gjithë qata emnat kanë vepru bashkë në maltratime dhe në tjera gjena. Me siguri i kanë pasë të mira.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Thjesht po të pyes të na thuash se çfarë di ti. Sa i takon Sabit Gecit, pra, ju thatë që ai kishte marrëdhënie të mirë me të.

PË. Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A mund të them që ai ishte krahu i djathtë i z. Sabit Geci?

PË. Po nuk po muj me të thënë unë 100 për qind të sigurtë, po me Sabitin kanë bashkëpu dhe shka ka thanë Sabiti kanë bë, se Sabiti ka qenë më i madh se këta. Raportet shifen, njëri kur të bisedon e qysh kjesh në sene shifet se i kanë raportet e mira, se ndryshe me një shok tem keshna ndryshe, me dikën tjetër. Këta i kanë pasë raportet e mira mes veti.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nga e di ti këtë? Si mund ta dish këtë? Se po thua që "mendoj që kanë pasë marrëdhënie të mira". Kështu që pyetja që kam për ju tani është që nga e dije ti që ata kishin marrëdhënie të mira?

PË. Po më kanë tregu edhe pas luftës se kanë nejt këta bashkë, gjatë luftës edhe në tjera vende. Jo veç në Kukës, kanë nejt edhe nëpër Kosovë bashkë gjatë luftës. I kam të ndëgjume pi shokëve, pi njerëzve, se i kanë raportet e mira.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Por e kam fjalën kur ishit në Kukës? Domethënë i ke parë vetë. A i ke parë që të ndërvepronin, që të flisnin me njeri-tjetrin?

PË. Po i kam pa aty se kanë folë e kanë kjeshë. Edhe ka qenë ult i pari ky, ka qenë bashkë, ngjitë, me Sabitin ult a kanë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pyetja tjetër ka të bëjë me Xhemshit Krasniqin. Nga kush i

merrte urdhrat Xhemshit Krasniqi? A e di këtë?
PË. Jo, nuk e di, se Xhemshiti ka ardhë edhe shpesh, ka ardhë, ma së shumti ka ardhë Xhemshiti në dhomë tonë. Ka ardhë edhe pa këta, pa prezencë tynëve ka ardhë disa herë. Sa e di unë Xhemshiti e ka pasë përgjegjësinë e burgit, të burgosun. Dhe ata jam, bile nja 90 për qind i bindum.
Po kur ka qenë Sabiti aty, ai a kanë kryesori. Se s'kanë guxu me ja lujt asnjëni.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani do të diskutoj shkurtimisht me ju një deklaratë të mëparshme të ke dhënë. Është dokumenti 083219-TR-ET Pjesa 1 e Rishikuar. Në versionin në shqip është faqja 44 [sipas përkthimit], është vetëm rreshti 5. Ndërkohë që në përkthimin në anglisht jemi në faqen 33. Shumë mirë. Faleminderit.
Rreshti 5, ju thoni:
"Që të gjithë merrnin urdhra nga Sabit Geci".
Përfshirë këtu edhe z. Krasniqi?
PË. Po.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e dini se nga kush i merrte urdhrat Sabit Geci?
PË. Nuk e di. Në atë kohë Sabiti ka qenë shumë njeri i fortë, dona tash vonë. Tash është pak ndryshe ka lujt situata, po Sabiti a kanë shumë, shumë njeri i fortën në atë kohë. Nuk ka pyet ka nej fortë. Dhe s'besoj se e ka pyt kënd bile.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,

ideja është që ju po thoni që nuk e dini se nga kush i merrte urdhrat ai, kështu?

PË. Po. Veç e di se ka qenë shumë i fortë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar.

Kam një pyetje tjetër. Pyetja ka të bëjë me një temë të cilën e mbuluat pjesërisht në dëshminë tuaj. Ju dëshmuat përpara Trupit Gjykues lidhur me faktin se kur e ke parë z. Shala në shtab ku të kanë keqtrajtuar, domethënë, ku e patë z. Shala në shtab kur ju keqtrajtuan. Kjo përmendet në transkriptin e datës 31 maj, në faqen 1537, rreshtat 2 deri në 10.

Pyetja që kam për ju tani është kjo: Gjatë periudhës që ke qëndruar atje, me aq sa kujtoni, sigurisht, sa herë e ke parë z. Shala atje?

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta formuloj ndryshe fjalinë. Do të përpiqem që të rifreskoj kujtesën me një deklaratë të mëhershme që ke dhënë. Në qoftë

se nuk të kujtohet, na thuaj. Pra, në qoftë se nuk të kujtohet se sa herë e ke parë atë atje, mund të na e thuash këtë gjë. Pra, na thoni në qoftë se s'ju kujtohet.

Megjithatë, përpara sesa të marrim përgjigjen tuaj, le të kalojmë tek pjesa e deklaratës së mëparshme. A ju kujtohet, sipas asaj që ke parë me sytë tuaj, a ju kujtohet numri i herëve që ai pretendohet të ketë keqtrajtuar dikënd?

PË. Nuk më kujtohet për besë se ka shku kohë e gjatë dhe i kam harru do gjena shumë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë dua që të kërkoj që të paraqitet një deklaratë e me përparshme e juaj e cili është me numër identifikimi 083219-TR-ET Pjesa 4, faqja 14. Kjo përkon me faqen 19, janë dy rreshtat e parë të kësaj faqeje në versionin në shqip. Pastaj kemi faqen 14 -- faleminderit, znj. Sekretare, që po e shfaqni në ekran.

Atëherë pyetja që iu bë juve në faqen 14, rreshti 5 dhe 6:

"Pjetër Shalën sa shpesh e ke parë gjatë kohës që je mbajtur në Kukës?"

Dhe përgjigja që ke dhënë ti është kjo:

"Ai ka marrë pjesë në 10, 12 raste maltrajtimesh që kanë ndodhur aty".

A ju kujtohet, ju kujtohet ndonjë gjë pasi e lexuam këtë?

PË. Nuk më kujtohet për besë, po ndoshta i kam thënë. Edhe këto se më ka përmend dikush në dhomë se i ka rreh. Se mua 10, 12 nuk më ka rreh 10, 12 herë. Se s'un ja shpifi një gjë se s'është. Po nuk po më kujtohet krejt, se më ka kalu një kohë bajagi e gjatë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk do të ngul këmbë. Është një pyetje që jua bëra, po edhe ashtu siç u përgjigjët tani në formë të përmbledhur është ekzaktësisht siç është e shkruar këtu, po nuk ishte në lidhje me ju.

Mund ta heqim nga ekrani, znj. Sekretare, këtë dokument.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. Dëshmitar, kemi përfunduar kështu dëshminë tuaj përpara këtij Trupi Gjykues. Dëshiroj t'ju falënderoj shumë për përpjekjet tuaja për të dhënë dëshminë këto ditë këtu. Ju rikujtoj se nuk duhet ta diskutoni me kënd dëshminë që keni dhënë përpara këtij Trupi Gjykues.

Ju uroj udhëtim të mbarë, kthim të mbarë në shtëpi. Dhe ju falënderoj sërish. Znj. Asistente e sallës do ju shoqëroj të dilni.

DËSHMITARI: Faleminderit edhe pej jush. Sa kam mbajt mend

kam folë, ma tepër diçka që s'e mbaj mend s'muj me e folë. Kaq. Faleminderit edhe prej jush. Shka e kam pasë, se e kam ditë, se e kam kujtu, i kam shpreh qëtu. Kaq pata me ju. Dhe pej jush faleminderit. Kalofshi mirë, çdo të mirë.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Asistente e sallës.

Përpara se ta ndërpresim seancën, do të japim një vendim gojarisht mbi një aspekt dhe ky vendim mund të jepet publikisht.

Është një vendim i dhënë gojarisht mbi kërkesën e Mbrojtjes për rishqyrtim të vendimit lidhur me deklaratat e mëparshme që ka dhënë Pjetër Shala. Është parashtrim i protokolluar me numër 515.

Trupi Gjykues i ka marrë në konsideratë të gjitha parashtrimet e bëra nga palët, përfshirë dhe përgjigjen e ZPS-së, që është parashtrim protokolluar me numër 527 dhe kundërpërgjigjen e Mbrojtjes, parashtrimi i protokolluar me numër 533 dhe - në fakt do japin tani një përmbledhje të asaj që do të vendosim – e rrëzojmë kërkesën.

Së pari, Trupi Gjykues vëren se rishqyrtimi nuk duhet të përdoret si një mjet juridik i dytë apelimi apo për të riparashtruar kërkesa përpara Trupit Gjykues për të cilat është marrë më përpara. Pranueshmëria e deklaratave të akuzuarit është parashtruar si kërkesë gjerësisht përpara

këtij Trupi Gjykues. Trupi Gjykues atëherë i ka dhënë leje Mbrojtjes që të apelojë vendimin e vetë, me parashtrimin e protokolluar numër 401. Mbrojtja e ka bërë këtë gjë dhe Gjykata e Apelit ka marrë vendim mbi këtë aspekt dhe e ka lënë në fuqi vendimin e Trupit Gjykues. Mbrojtja nuk mund të përdorë rregullën 79 të Rregullores për të rihapur çështje për të cilat është marrë tashmë vendim për shkak se ajo nuk pajtohet me rezultatin.

Së dyti, sipas rregullës 79 të Rregullores rishqyrtimi i një vendimi është një mjet juridik përjashtimor, që do të thotë se pala që kërkon rishqyrtim duhet që të përmbushë një standard të lartë për të treguar që Trupi Gjykues ka bërë një gabim në arsyetim apo se rishqyrtimi është i domosdoshëm për të shmangur padrejtësinë dhe në këtë rast. Trupi Gjykues nuk është i bindur se Mbrojtja e ka përmbushur këtë standard. Ndërkohë që Paneli i Gjykatës së Apelit ka konstatuar se ky Trup Gjykues ka bërë një gabim në konstatimin e vet se z. Shala në përgjithësi nuk u pengua nga mundësia për të përdorur një avokat gjatë intervistës së tij me policinë gjyqësore federale belge dhe në vitin 2016, ky panel i Gjykatës së Apelit është shprehur se shkelja e të drejtave të njeriut të z. Shala atëherë ishte "e kufizuar". Dhe këtu i referohem parashtrimit të protokolluar me numër IA-006/parashtrimit të protokolluar 00007, paragrafi 79. Paneli i Gjykatës së Apelit gjithashtu ka shprehur qartë se ky nuk ka gjetur "asnjë

tregues të pabesueshmërisë apo të një dëmtimi të mundshëm në integritetin e procedurës së intervistës që është pranuar".

Në fund, Trupi Gjykues mendon se është e rëndësishme që të ruhet parimi i finalitetit, pra, i faktit që vendimi është formës së prerë dhe konstaton se rishqyrtimi nuk është i justifikuar.

Për këto arsye, Trupi Gjykues rrëzon kërkesën e Mbrojtjes.

Këtu mbyllet ky urdhër gojarisht.

Kemi ardhur thuajse në fund të kësaj seance. Do të kemi seancën tjetër më 16 qershor. Po shikoj nga ZPS-ja për të parë nëse është çdo gjë në rregull.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, besojmë se është çdo gjë në rregull, janë siguruar dhe përkthyesit dhe konfirmojmë se çdo gjë është në rregull. Pra, do t'ju vëmë në dijeni nëse ka ndonjë problem, po hë për hë, nuk shohim ndonjë problem.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Ka një korrigjim nga kabina e përkthimit.

PËRKTHYESJA: [Përkthim] Përkthyesit duan të korrigjojnë në faqen 78, rreshti 24. Nuk e di nëse këtë mund ta bëjmë në seancë publike apo private, sepse nuk na kujtohet nëse ishim në seancë private apo publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F535RED dhe F631.*

shohim, ka qenë në fakt ajo pjesë në seancë private. Do të kalojmë tani në seancë private pastaj do të kthehemi në seancë publike edhe mund të vijojmë pastaj.

Znj. Sekretare, na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit shumë.

Z. Prokuror, ju po informoni Trupi Gjykues se nëse do të

ishte nevoja për të na përditësuar më tej do të na informoni sa më shpejt të jetë e mundur.

Në rregull atëherë. Po do t'ju jap fjalën të gjithëve njëherë nëse keni ndonjë problem për të ngritur, z. Prokuror?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse, asgjë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtës i Viktimave.

Z. LAWS: [Përkthim] Jo, faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse. Nëse më lejoni disa sekonda kohë që në emër të z. Gilissen, znj. Cariolou dhe vetes duam të falënderojmë ekipin që na ka ndihmuar në veçanti, znj. Camille Gosson dhe z. Mathias Lenlet të cilët janë stazhierët e ekipit tonë të cilët do të largohen pas këtij blloku, sepse si stazhierë kanë dhënë një kontribut shumë të madh përtej nga ajo që pritet prej tyre, prandaj përfitoj nga rasti që t'i falënderoj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E mbajtëm shënim këtë.

Atëherë nëse nuk ka gjë tjetër për të ngritur përpara Trupit Gjykues, është momenti për mua tani, meqenëse po e mbyllim seancën për këtë grup të tretë dëshmish, të falënderoj disa njerëz. Falënderoj personelin e sigurisë, stenografen dhe ekipin audiovizivë, përkthyesit për ndihmën. Falënderoj dhe

palët dhe Mbrojtësin e Viktimave për praninë.

Këtu ndërpritet seanca.

--- Seanca mbyllet në orën 15.04